



URDHËR

Nr. 70, datë 18.4.2016

PËR

**MARRJEN E MASAVE PËR THJESHTËZIMIN E FORMALIZIMIT  
TË DOKUMENTACIONIT TË REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE  
NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, të cilat, sipas akteve ligjore dhe nënligjore, janë ngarkuar për regjistrimin, licencimin dhe veprimet administrative të biznesit, të marrin masa të menjëhershme për thjeshtëzimin e formalizimit të dokumentacionit të kërkuar për procedurat e sipërpërmendura.
2. Institucionet regjistruese, licencuese dhe ato të ngarkuara për veprimet procedurale, të përmendura në pikën 1, të këtij urdhri, të ndërpresin menjëherë çdo kërkesë ndaj subjekteve për vulosjen e dokumentacionit të kërkuar dhe për detyrimin për të njësuar fotokopjet e dokumentacionit të paraqitur me origjinalin, në çdo rast që një formalitet i tillë nuk parashikohet në dispozitat ligjore apo nënligjore në fuqi. Në këto raste, për çdo procedurë të pranohet dokumentacioni në origjinal ose kopje të panjësuar me origjinalin.
3. Institucionet e parashikuara në pikën 1, të këtij urdhri, brenda datës 30 prill 2016, të identifikojnë dhe të amendojnë të gjitha udhëzimet e të gjithë urdhrat, formularët e regjistrimit dhe dokumentacionin tjetër, të miratuar prej

tyre në lidhje me regjistrimin, licencimin dhe procedurat e tjera të funksionimit të biznesit, ku kërkohet vulosja e dokumentacionit të kërkuar me vulën e subjektit dhe detyrimi për të njësuar fotokopjet e dokumentacionit të paraqitur me origjinalin, dhe t'i ndryshojë ato duke hequr çdo kërkesë të tillë dhe duke pranuar dokumentacionin në origjinal ose si fotokopje të njësuar me origjinalin.

4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në mbështetje të pikës 3, të këtij urdhri, të raportojë në kabinetin e Kryeministrit për ecurinë e këtij procesi.
5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të koordinojë dhe të ndjekë zbatimin e këtij procesi, sipas pikës 3, të këtij urdhri.
6. Ngarkohen të gjitha institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**



NR.PROT.2189/1  
DATE 19.4.2016

MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,  
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
GJITHË MINISTRIVE  
GJITHË BASHKIVE  
QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT  
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACE

